



Rama: Dialog me protagonistë nga të tëra fushat e zhvillimit bujqësor e rural

Faqe 2



Kreditimi i sektorit bujqësor në nivele të ulëta, Guvernatori Sejko: Duhet rregulluar një orë e më parë! Programi i BSH

Faqe 2



Rezultate dhe konkluzione mbi "Parametrat analitikë të vlerësimit të cilësisë dhe pastërtisë së vajit të ullirit për eksport"

Faqe 5



AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15-ditëshi i parë i muajit korrik 2025

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 513
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

REZULTATET E VLERËSIMIT TË ZINXHIRIT TË VLERËS PËR (BAM) PËRPUTHSHMËRIA ME STANDARDET DHE CILËSIA - ÇELËSI I SUKSESIT TË SHQIPËRISË NË TREGUN EVROPIAN TË VAJRAVE ESENCIALE

Qeveria Zvicerane mbështet sektorin bujqësor nëpërmjet ndërhyrjeve të Programit Global Për Cilësi dhe Standarde që zbatohet nga UNIDO, duke synuar të rrisë në mënyrë të qëndrueshme akses në tregje kombëtare dhe ndërkombëtare për SME-të në zinxhirët e vlerave BAM dhe F&V, duke forcuar cilësinë dhe kapacitetin e përputhshmërisë me standardet

GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME | **ALBANIA**

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS
INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Malaj: Garancia Sovrane, model i ri i zhvillimit rural dhe ekonomik



Faqe 4

LIBRA TË RINJ



Dy botime me vlerë të Prof. Lufter Xhuvelit

Nga: Fuat Memelli

Faqe 10

TEMA TË DITËS

- Tokat 'djerrë', sipërfaqja e mbjellë ulet në 677 mijë hektarë! Tregu 'tremb' kultivuesit e grurit, prodhuan 22% më pak! Bankat strikte, dhanë vetëm 6 mln euro hua Fq.2
- Rama: Mbështetje për pika të reja të mbarështimit të të imtave në natyrë Fq.4
- Temperaturat e larta nuk ndalin fermerët e Kukësit, pas korjes së grurit ka nisur mbjellja e misrit Fq.6
- Skema kombëtare e naftës, janë verifikuar mbi 70% e dosjeve për 1.380 fermerët e qarkut Gjirokastrë Fq.7
- Drurët dhe pemët më të pazakonta në Tokë - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

POLITIKA FISKALE

Tatimet, fushatë informuese për formalizimin e tregut bujqësor dhe blegtoral



Faqe 4

TEKNOLOGJI

Inovacioni, pjesë e zhvillimit bujqësor për uljen e kostove



Faqe 4

TEMA TË DITËS

Rama: Dialog me protagonistë nga të tëra fushat e zhvillimit bujqësor e rural

Kryeministri Edi Rama e dialogut për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural të zhvilluar në Cërrik.



Rama theksoi se kjo ditë ishte e gjatë dhe e frytshme me protagonistë nga të tëra fushat e zhvillimit bujqësor e rural.

“Mirë është që ne këtë lloj forumi ta mbajmë të ngritur, natyrisht mund ta pasurojmë, mund të vijmë dhe të tjerë. Të rishihemi pas disa muajsh për të parë çfarë është bërë, çfarë s’është bërë”, tha Rama.

Dialogu për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural përmbylli pasditen e djeshme punimet e ditës së parë, i cili u fokusua në dëgjimin aktiv të pjesëmarrësve, dhe evidentimin e temave më të rëndësishme për sektorin, e më pas në zhvillimin e tryezave të diskutimit.

Në fjalën e tij, Kryeministri Edi Rama theksoi se linja e kredisë 250 milionë euro e Bankës së Shqipërisë është një linjë kredie jokonvencionale që nuk ka interesat e një kredie që jep sot banka.

Rama foli edhe për “Paketën e Maleve”, që sipas kreut të qeverisë, “rrezikon të mbetet e pashfrytëzuar, nëse ne nuk i bashkojmë forcat për të dhënë informacion, për t’u linjësuar me subjektet dhe duke u bërë ne aktivë, duke i kërkuar ne, kapacitetet në këtë proces”.

Tokat 'djerrë', sipërfaqja e mbjellë ulet në 677 mijë hektarë! Tregu 'tremb' kultivuesit e grurit, prodhuan 22% më pak! Bankat strikte, dhanë vetëm 6 mln euro hua

Më pak tokë po punohet në Shqipëri. Shifrat zyrtare tregojnë se vjet është mbjellë vetëm 677 mijë hektarë tokë bujqësore, me tkurje prej 20 mijë hektarë në dekadën e fundit. Shkaqet janë disa, por emigrimi dhe mungesa e financimit po godasin prodhimin shqiptar

Largimi i banorëve nga zonat rurale, mungesa e fuqisë punëtore, financimi i ulët dhe ngecja tek makineritë e vjetra po e mbajnë bujqësinë në krizë, duke dhënë kontribut negativ në rritjen ekonomike.

Brenda 6 viteve sipërfaqja e tokës bujqësore të mbjellë sipas shifrave të INSTAT ka rënë me rreth 20 mijë hektarë. Përgjatë gjithë vitit të kaluar shifrat zyrtare tregojnë se u mboll në total nga perimet e deri tek bimët medicinale 677 mijë hektarë nga 696 mijë hektarë në 2019-ën.

Shifrat e INSTAT tregojnë se vjet pati një rënie të prodhimeve, me përjashtim të perimeve, ku objektivi kryesor i fermerëve është tregu i huaj. Sipërfaqja e mbjellë kryesisht me domate e specat u rrit në rreth 45 mijë hektarë nga afro 43 mijë në 2023-shin. Në total, fermerët prodhuan vjet 1.4 milionë tonë perime.

Për shkak të mungesës së

tregut, fermerët mbollën më pak grurë vjet. Nga 57 mijë hektarë në vitin 2023 ku kultivuan 233 mijë tonë, vjet u prodhuan në total 180 mijë tonë grurë në një sipërfaqe prej më pak se 46 mijë hektarë të mbjellë.

Siguria kombëtare varet edhe nga bujqësia, një tezë kjo e provuar edhe në kohë lufte, si ajo në Ukrainë, ku viti 2022 na përballi me çmime stratosferike nga drithërat e deri tek produktet e tjera të konservuara. Sa më i madh prodhimi vendas thonë ekspertët aq më pak rriten çmimet, por kur prodhimi ngec ekspozimi nga tregjet e huaja është i lartë dhe fatura rritet.

Një nga faktorët kryesorë pse fshati po braktiset e bujqësia po tkurret është financimi i ulët i bujkut. Mbështetje që jepet jo vetëm me subvencione por edhe me kredi. Sektori që punëson më shumë se 450 mijë qytetarë kryesisht në zonat rurale apo biznese të vogla famil-

jare dhe që jep kontribut në Prodhimin Kombëtar me afro 18%, merr si financim vetëm 1.8% të buxhetit të shtetit dhe më pak se 1.3% të totalit të kredisë që japin bankat.

Nga 8.2 miliardë euro shpenzime për vitin 2025, për bujqësinë u ndanë vetëm 145 milionë euro. Ndërsa sektori bankar vijon të tregohet strikt me këtë sektor, pasi stoku i kredisë së dhënë për bujqësinë në fund të vitit 2024 ishte vetëm 63 milionë euro ose 1.3% e totalit të huasë së dhënë për bizneset.

Kredia e re e dhënë në 5 muajt e parë të këtij viti për bujqësinë ishte 6.6 milionë euro, ose 43% më pak se e njëjta periudhë vjet kur u miratuan 15 milionë euro kontrata kredie për këtë sektor. Për të nxitur bankat të japin më shumë kredi për këtë sektor, qeveria ka miratuar garancinë sovranë prej 30 milionë euro, që parashikon kredi të buta, por ende nuk ka hyrë në fuqi.

Kreditimi i sektorit bujqësor në nivele të ulëta, Guvernatori Sejko: Duhet rregulluar një orë e më parë! Programi i BSH ofron bazë të sigurt fondesh! Apeli për përfaqësuesit e sektorit bankar

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, në tryezën e diskutimit për nxitjen e kreditimit në sektorin bujqësor, ka deklaruar se niveli i kreditimit për këtë sektor është i ulët dhe se duhet korrigjuar

“Ky sektor siguron rreth 20% të PBB-së së vendit dhe ofron punësim për rreth 1/3 e popullsisë, ndërkohë që përfiton më pak se 2% të kredisë totale,” deklaroi Sejko, ndërsa theksoi se nivelet aktuale të kreditimit për bujqësinë mbeten të ulëta.



“Kjo është një mangësi, e cila duhet korrigjuar një orë e më parë, nëse synojmë të nxisim zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori jetik për ekonominë shqiptare”, tha ai.

Ai theksoi se Banka e Shqipërisë ka vendosur në qendër të Programit të saj të Financimit të biznesit mikro, të vogël dhe të mesëm, pikërisht rritjen e kredisë për bujqësinë, duke ofruar një platformë të sigurt fondesh me kosto të ulët.

“Banka e Shqipërisë vendosi në fokus të Programit të saj të Financimit të Biznesit Mikro, të Vogël e të Mesëm, rritjen e kredisë për sektorin bujqësor. Ky program, pjesë e së cilit janë bërë të gjithë aktorët e sektorit bankar, ju ofron ju një bazë të sigurt e të qëndrueshme fondesh, me kosto të ulët, për kreditimin e projekteve të zhvillimit të sektorit bujqësor, duke përfshirë edhe agroturizmin dhe industrinë agroushqimore”, tha ai.

Sejko u ka bërë thirrje përfaqësuesve të sistemit bankar që të rishikojnë qëndrimin ndaj bujqësisë, jo vetëm si një mundësi ekonomike, por edhe si një detyrim shoqëror.

“Si aktorë të rëndësishëm në jetën shoqërore të vendit, mbështetja e sektorit bujqësor duhet të shihet edhe si detyrim moral ndaj Shqipërisë, vendi në të cilin zhvillonim me siguri dhe rentabilitet biznesin tuaj. Përkrahja e industrisë së zinxhirit ushqimor mbetet një faktor me rëndësi të vërtetë jetike për një vend dhe popullsinë e tij”, u shpreh Sejko.

Duke iu drejtuar përfaqë-

suesve të sistemit bankar, Guvernatori tha më tej se Banka e Shqipërisë nuk do të marrë masa që mund të cenonjë qëndrueshmërinë e bilanceve të tyre financiare apo që bien ndesh me interesat e stabilitetit financiar të vendit në afatin e gjatë.

Guvernatori Sejko: Në radhë të parë, dëshiroj t’ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë tryezë diskutimi, të organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Kjo tryezë ka për qëllim të identifikojë rrugët dhe instrumentet e duhura për hapjen e një kapitulli të ri në kreditimin e sektorit bujqësor të vendit.

Sikundër e kemi theksuar edhe në shumë tryeza e platforma të mëparshme komunikimi, kreditimi i sektorit bujqësor ka qenë dhe mbetet një dobësi strukturore e ekonomisë dhe e sektorit tonë bankar.

Kjo dobësi ilustron qartë nëse krahasojmë peshën e madhe që ka sektori bujqësor në ekonominë shqiptare me nivelin e kreditimit që ai përfiton nga sektori bankar. Ky sektor siguron rreth 20% të PBB-së së vendit dhe ofron punësim për rreth 1/3 e popullsisë, ndërkohë që përfiton më pak se 2% të kredisë totale. Për më tepër, trendet e viteve të fundit nuk janë aspak pozitive.

Arsyet e shkallës së ulët të kreditimit të sektorit bujqësor – duke filluar nga problemet e pronësisë dhe duke vijuar me nivelin e lartë të informalitetit, rrezikun relativisht të lartë të biznesit, si dhe produktivitetin e ulët si pasojë e mungesës së ekonomive të shkallës, – i kemi diskutuar në vazhdimësi. Një pjesë e këtyre problemeve mbeten ende relevante, ndërkohë që një pjesë tjetër e tyre janë drejt zgjidhjes.

Megjithatë, edhe në këtë kontekst sfidues, nivelet aktuale të kreditimit për bujqësinë mbeten të ulëta. Kjo është një

mangësi, e cila duhet korrigjuar një orë e më parë, nëse synojmë të nxisim zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori jetik për ekonominë shqiptare.

Të ndërgjegjshëm për këtë, Banka e Shqipërisë vendosi në fokus të Programit të saj të Financimit të Biznesit Mikro, të Vogël e të Mesëm, rritjen e kredisë për sektorin bujqësor. Ky program, pjesë e së cilit janë bërë të gjithë aktorët e sektorit bankar, ju ofron ju një bazë të sigurt e të qëndrueshme fondesh, me kosto të ulët, për kreditimin e projekteve të zhvillimit të sektorit bujqësor, duke përfshirë edhe agroturizmin dhe industrinë agroushqimore.

Së fundmi, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë hapa konkretë në këtë drejtim, duke vënë në dispozicion një skemë garancie sovranë për kreditë e dhëna ndaj sektorit bujqësor. Kjo garanci ul ndjeshëm rrezikun e kreditimit të këtij sektori, duke reduktuar ndjeshëm dhe një nga problemet fundamentale që kemi diskutuar, kolateralin.

Në gjykimin tonë, këto dy projekte zhvillimi ofrojnë një platformë solide për të hedhur një hap të ri cilësor përpara në kreditimin e bujqësisë. Megjithatë, suksesi i kësaj platforme varet në një masë të madhe nga përfshirja dhe angazhimi juaj për shfrytëzimin e instrumenteve të saj.

Në këtë kontekst, më lejoni të tërheq vëmendjen tuaj në tre momente të rëndësishme.

Së pari, në aspektin e ngushtë të interesit të bizneseve që ju drejtoni, dëshiroj të theksoj se shkalla e ulët e kreditimit të sektorit bujqësor nuk duhet të shihet vetëm si dëshmi e problemeve që ekzistojnë në këtë proces, por dhe si tregues potencial i kthimit të lartë që mund të siguroni nga investimi në të. Për këtë arsye, ju ftoj t’i jepni bujqësisë vëmendjen dhe ekspertizën që meriton.

Së dyti, në aspektin e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, rritja e sektorit bujqësor në sinkron dhe paralel me sektorët e tjerë të ekonomisë, duhet parë si një element esencial për zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit. Nga ky këndvështrim, si aktorë primarë në jetën ekonomike dhe financiare të vendit, ju duhet të konsideroni kreditimin

(Vijon në faqen 7)

REZULTATET E VLERËSIMIT TË ZINXHIRIT TË VLERËS PËR (BAM)

PËRPUTHSHMËRIA ME STANDARDET DHE CILËSIA - ÇELËSI I SUKSESIT TË SHQIPËRISË NË TREGUN EVROPIAN TË VAJRAVE ESENCIALE

Qeveria Zvicerane mbështet sektorin bujqësor nëpërmjet ndërhyrjeve të Programit Global Për Cilësi dhe Standarde që zbatohet nga UNIDO, duke synuar të rrisë në mënyrë të qëndrueshme akses në tregje kombëtare dhe ndërkombëtare për SME-të në zinxhirët e vlerave BAM dhe F&V, duke forcuar cilësinë dhe kapacitetin e përputhshmërisë me standardet

Ky artikull është pjesë e një raporti që detajon rezultatet e vlerësimit të zinxhirit të vlerës për bimët mjekësore dhe aromatike (BAM). Ky vlerësim u krye në kuadër të projektit “Analiza e zinxhirit të vlerës së bimëve, frutave dhe perimeve aromatike dhe mjekësore në Shqipëri”, e mandatuar nga UNIDO si pjesë e Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve (GQSP) dhe financuar nga Qeveria Zvicerane. Një raport përkatës është përgatitur për sektorin e pemëve dhe perimeve (F&V).

GQSP në Shqipëri synon të rrisë në mënyrë të qëndrueshme aksesin në treg për SME-të në zinxhirët e vlerave BAM dhe F&V duke forcuar cilësinë dhe kapacitetin e përputhshmërisë me standardet. Programi fokusohet në infrastrukturën e cilësisë dhe pajtueshmërisë, si dhe në kërkesat ekonomike, sociale dhe të qëndrueshmërisë.

KËRKESAT PËR EKSPORT NË VENDET E BE-SË¹

Kërkesat për eksportin e vajrave esenciale në Bashkimin Evropian


Kërkesat ligjore në funksion të fazës së zinxhirit të furnizimit

Kërkesat ligjore për të importuar vajra esenciale në lidhje me fazën e zinxhirit të furnizimit janë si më poshtë:

Tabela 1. Kërkesat ligjore dhe fazat e zinxhirit të furnizimit		
Faza e zinxhirit të furnizimit	Rregullat e aplikueshme	Kontrolli i konformitetit
Prodhimi dhe grumbullimi i BAM-ve	GACP	Kontrollet dhe analizat kimike dhe fizike.
Nxjerrja e vajit esencial	GMP	
Paketimi/transporti i vajit esencial	Rregulloret REACH dhe CLP	Ambalazhimi, etiketat, dosja teknike.
Ruajtja/trajtimi i vajit esencial	Rregulloret REACH dhe CLP	
Përdorime specifike	Rregulloret në lidhje me përdorimin përfundimtar (kozmetikë, ushqim, mjekësi).	Specifike për çdo përdorim (shih më poshtë).

Lidhja ndërmjet fazave të zinxhirit të furnizimit dhe kërkesave ligjore është paraqitur në Figurën 1 më poshtë.

Figura 1: Kërkesat për eksport në BE në lidhje me fazën e zinxhirit të furnizimit



GACP dhe GMP e aplikueshme për mbledhjen e BAM-ve (BAM-të e egra) dhe kultivimin (BAM e kultivuar) dhe nxjerrjen e vajit esencial janë të standardizuara ndërkombëtarisht dhe jo specifike për tregjet e destinacionit (EMA, 2022; WHO, 2007).

Si rezultat i aplikimit të GAPC dhe GMP, sigurohet cilësia dhe siguria e vajrave esenciale të nxjerrë. Vaji esencial i prodhuar duhet të jetë në përputhje me karakteristikat tipike të atij produkti, të cilat për vajrat esenciale më të zakonshëm janë të zyrtarizuar në standardet ISO. Në disa raste, ka më shumë se një standard ISO, që lidhet me karakteristikat e ndryshme të vajit esencial të nxjerrë nga kultivarë të ndryshëm ose hibride të së njëjtës specie. Ky është rasti, për shembull, me vajrat esenciale të nxjerra nga bimët e gjinisë Lavandula , të cilat madje kanë emra të ndryshëm tregtarë (“vaj lavande” dhe “vaj lavandine”) në varësi të specieve nga e cila nxirret vaji esencial².

Një standard ISO për vajin esencial Helichrysum nuk është zhvilluar ende.

Tabela e mëposhtme tregon standardet ISO të referuara për produktet objekt të këtij dokumenti.

Tabela 2. Standardet ISO të vajrave esenciale me prioritet			
Vaj esencial i sherebelës	<i>S. officinalis</i> : ISO 9909: 1997 <i>S. Lavandulifolia</i> ISO 3526:2005	Helichrysum ess. Vaj	<i>I pazhvilluar</i>
Vaji esencial i rigonit	ISO 13171:2016	Vaj esencial livando <i>Lavendula angustifolia</i>	ISO 3515:2002
Vaj esencial trumze	ISO 19817:2017	Vaj esencial lavandine <i>Ankthi hibrid. x lat.</i> Grosso ISO 8902:2009	<i>Abrialis</i>

Përputhshmëria e vajit esencial me standardin përkatës ISO ose me karakteristikat e referencës që tregtohen zakonisht në tregjet ndërkombëtare (kur një standard specifik ISO nuk është zhvilluar ende) verifikohen nëpërmjet analizave fizike dhe kimike. Një sërë analizash të tilla zakonisht kërko-het nga blerësit.

Në veçanti, blerësit e BE-së kërkojnë pajtueshmëri në drejtim të:

1. *Substancave kimike të pranishme në vaj esencial*. Vajrat esenciale klasifikohen si NCS - një kategori e përbërjeve kimike (shih më poshtë). Si pasojë, vaji esencial i analizuar duhet të përmbajë vetëm substancat kimike karakteristike të asaj NCS. Për më tepër, prania e kimikateve nuk lejohet nga REACH. Rregullorja duhet të përjashtohet.

2. *Karakteristikat fizike*. Analiza e karakteristikave fizike fokusohet në:

- Ngjyrë;
- Shije,
- Dendësia;
- Rrotullimi optik;
- Indeksi i thyerjes;
- Tretshmëria në ujë dhe vaj (sa lehtë tretet vaji esencial).

Përveç kërkesave ligjore, shumë blerës kanë kërkesa shtesë.

Segmentimi i tregut

Tregu evropian i vajrave esenciale është i ndarë në tre segmente, duke ofruar kanale të ndryshme importi. Në këtë dokument, ne do të shqyrtojmë vetëm kërkesat për eksportin e vajrave esenciale të destinuar për përdorim ushqimor ose kozmetik; nuk do të merren parasysh kërkesat e vajrave esenciale të përdorura për detergjentë dhe produkte farmaceutike.

Vaji esencial i rigonit, sherebelës dhe trumzës përdoren më së shumti në industrinë ushqimore; Vajrat esenciale të livandës dhe helichrysum në industrinë e kozmetikës dhe detergjentit.

Nga pikëpamja ligjore, vajrat esenciale për aromatizues (dmth. një kategori produktesh ushqimore) nuk i nënshtrohen të njëjtave kërkesa për dokumentacion si vajrat esenciale për aplikime të tjera si aromat (një kategori produktesh kozmetike). Rregullorja REACH kërkon që furnizuesit e vajrave esenciale për këto aplikime alternative të ofrojnë shumë më tepër dokumentacion. Vajrat esenciale për aromatizues janë të përjashtuar nga REACH.

Megjithatë, në praktikë, blerësit evropianë të vajrave esenciale për aromatizues shpesh kanë të njëjtat kërkesa dokumentacioni si blerësit e vajrave esenciale për përdorime të tjera. Meqenëse ata nuk e dinë se si klientët e tyre do ta përdorin vajin esencial, ata duhet të kenë të gjithë dokumentacionin e kërkuar për aplikime të ndryshme të mundshme, duke përfshirë aromatizuesit dhe aromat.

Pavarësisht nga përdorimi i synuar, vaji esencial që do të tregtohet në BE duhet të jetë në përputhje me Reg. (EC) 1272/2008 (rregullorja “CLP4”, mbi etiketimin e kimikateve të rrezikshme), e përshkruar më poshtë.

Është e mundur që blerësi të kërkojë që vaji esencial i eksportuar të jetë në përputhje me kërkesat që lidhen me kategori të ndryshme (p.sh. kozmetikë dhe ushqime), në mënyrë që të rishitet vaji esencial tek një gamë më e gjerë klientësh.

Pajtueshmëria me rregulloret e BE-së

Furnizuesit e përbërësve natyralë nga vendet jo anëtare të BE-së duhet të miratojnë praktikat e pranuarra të nxjerrjes (në rastin e nxjerrjes me avull), të përdorin etiketimin në përputhje me Rregulloren CLP. Gjithashtu, informacioni për substancat potencialisht të rrezikshme duhet të përfshihet në Fletët e të Dhënave të Sigurisë (SDS), siç specifikohet në rregulloren REACH. Mosrespektimi i rregulloreve CLP dhe REACH do të rezultojë në pamundësi për t'u shitur në marketet e BE-së.

AKTUALITET

Rama: Mbështetje për pika të reja të mbarështimit të të imtave në natyrë

Kryeministri Edi Rama deklaroi se duhet të krijojmë pika të reja të mbarështimit të të imtave në natyrë.

“Stani i Çajupit është një shembull spektakolar jo thjesht për blegtorinë, por edhe për turizmin, dhe koncepti i integruar i këtij stani, i kombinuar me blegtorinë dhe turizmin, është një koncept fitues”, tha Rama, në fjalën përmbyllëse pas diskutimeve të Ditës së Parë të Dialogut për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural mes fermerëve dhe sipërmarrësve në bujqësi për një urë të re komunikimi në funksion të rrugës së anëtarësimit të Shqipërisë 2030 në BE.

Kryeministri Rama bëri të ditur se “kemi diskutuar për të dalë me një program të posaçëm për të mbështetur krijimin e staneve dhe fermave në

naturë, në fushë. Siç pashë, ka gatishmëri”.

“Në Korçë kemi dy sipërmarrje të dalluara në përpunimin e mishit. Kanë të gjithë të drejtën, të shqetësuar nga njëra anë për sa i përket konkurrencës që bëhet si rezultat i pamundësisë për të ndarë importin e mishit për shitje nga importi i mishit për nënproduktet e tij, dhe duhet ta adresojmë këtë çështje”, nënvizoi Rama.

Por, vijoi Kryeministri, “nga ana tjetër kemi shumë të drejtë dhe duhet t’u kërkojmë, dhe ata e pritën më shumë entuziazëm, që të përfshihen në krijimin e një zinxhiri të blegtorisë për të pasur shumë më tepër prodhim mishi vendas në treg dhe për të eksportuar”.

Kreu i qeverisë vuri në dukje se duhet të krijojmë masë kri-

tike dhe mund ta bëjmë duke bërë njëkohësisht një blegtori të lidhur me natyrën.

“Është bërë e modës fjala “bio”, por të jetë tërësisht në natyrë, po kështu edhe ferma fushore janë të mundura, por kërkojnë mbështetje nga ana jonë. Nuk kemi arsye të stepe mi nga kjo situatë, nga inercia e rënies së numrit të krerëve, por përkundrazi, duhet të përgjigjemi me një politikë agresive në këtë drejtim, sepse është një politikë fituese”, theksoi Rama.

Më tej, Rama u shpreh se “çështja e ushqimit në tërësi dhe prodhimit të ushqimit duhet ta kthejmë në një çështje me prioritet edhe më të madh se e kemi pasur për këtë arsye i kemi dhënë një mbështetje edhe më të madhe Universitetit Bujqësor”.



Inovacioni, pjesë e zhvillimit bujqësor për uljen e kostove

Kryeministri Edi Rama deklaroi se inovacioni duhet të bëhet pjesë e pandashme e zhvillimit të sektorit bujqësor, përmes përdorimit të teknologjive të reja dhe energjive alternative.

Në fjalën përmbyllëse pas diskutimeve të Ditës së Parë të Dialogut për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, një platformë komunikimi mes fermerëve dhe sipërmarrësve, Rama theksoi se ulja e kostove për prodhuesit duhet të vijë edhe përmes qasjeve inovative dhe investimeve të qëndrueshme në energji.

“U tha aty shumë qartë, që

ndërkohë që shikojmë këto aspekte, duhet të mendojmë dhe për uljen e kostove dhe duhet të jemi inovativë në shumë drejtime. Duhet të shfrytëzojmë edhe mbetjet e punës në bujqësi për të përfutur përmes riciklimit. Kemi shembull të shkëlqyer në Cërrik, ku falë qartësisë së kryetarit të Bashkisë së Cërrikut, që e kemi model në këtë punë dhe që ka sjellë një propozim tjetër për ta futur edhe IA-në në këtë proces, duhet të angazhohemi bashkërisht, qeveria, njësitë vendore dhe sipërmarrja për të ndërtuar sistemet e biogazit, që kanë një investim

të konsiderueshëm fillimisht, por që kanë fitim. Në këtë investim duhet të ndërhyjmë ne, qeveria, njësitë vendore etj. Sipërmarrja këtë vetë e ka të pamundur, pasi ka barrë nga më të mëdhatë, e s’mund t’i kërkojë të investojë në një sistem që ka përfitime të mëdha, por që investimin fillestar e ka të madh”, tha Rama.

Ai vuri në dukje se për të shfrytëzuar potencialin e plotë të bujqësisë, është e nevojshme që institucionet publike, njësitë vendore dhe sektori privat të bashkëpunojnë ngushtë në drejtim të modeleve të reja zhvillimi.



Malaj: Garancia Sovrane, model i ri i zhvillimit rural dhe ekonomik

Ministri i Financave, Petrit Malaj u shpreh se një nga prioritetet e Qeverisë shqiptare është rritja financiare në sektorin bujqësor, përmes një qasjeje dhe instrumenteve të reja bankare.

Gjatë punimeve të tryezës së diskutimeve me drejtuesit e

miliardë lekësh apo 30 milionë euro. Kjo garanci synon që të adresojë problematika, siç është mungesa e kolateralit, por që kërkon edhe të nxisë kreditimin e këtij sektori me një kosto sa më të ulët”, pohoi Malaj.

“Elementët kryesorë të



bankave tregtare, aktivitetet që u mbajt në ambientet e Bankës së Shqipërisë, ministri i Financave tha se bashkërendimi mes qeverisë, bankave dhe sektorit bujqësor do të forcohet për të bashkërenduar politikën për zhvillimin e ekonomisë bujqësore, si edhe për të ecur drejt vizionit “Shqipëria 2030” që kjo qeveri ka.

“Modeli që po synojmë të ndërtojmë ka në themel angazhimin e përbashkët të të gjithë aktorëve, siç janë qeveria, pushteti lokal, fermerët, madje edhe sektori bankar. Vetëm në këtë mënyrë ne do mund të ndërtojmë një sipërmarrje rurale të suksesshme dhe të fuqishme”, tha Malaj.

Sipas Malajt, potenciali në këtë sektor ekziston, sikundër edhe vullneti, por ajo që do të duhet të nxitet është rritja e aksesit në financë.

“Vitet e fundit, Qeveria shqiptare përmes Garancive Sovrane, katër të tilla, ka mbështetur sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Në vijim të kësaj përvojë pozitive që kemi pasur së bashku, ne po hedhim hapin e radhës për miratimin e një skeme të re Garancie Sovrane që për herë të parë do të mbështesë sektorin e bujqësisë me një fond prej 3

kësaj garancie janë sigurimi deri në 70% i vlerës së kredisë për fermerët dhe për SME-të në sektorin bujqësor. Do të ketë një normë të kufizuar në 2%, si edhe përdorimi i fondëve do të jetë ekskluzivisht për agropërpunimin, për përdorimin e mekanikës bujqësore, agroturizmin, peshkimin, serrat moderne etj.”, tha ai.

Ministri i Financave u shpreh se “kjo garanci nuk është vetëm një instrument financiar, por edhe një mundësi reale për të ndërtuar një model të ri të zhvillimit rural dhe ekonomik”.

“Bashkëpunimi me sektorin bankar është një nga çelësat e suksesit në këtë sektor. Niveli i kreditimit të bujqësisë nuk është në nivelet optimale, por të gjitha palët duhet të bëjnë përpjekjet maksimale për ta ndryshuar këtë situatë përmes politikave të bashkërenduara, një edukimi më të lartë financiar, apo duke ofruar produkte të dedikuara nga ana e bankave për këtë sektor”, pohoi Malaj.

“Në fakt, me vënien në dispozicion të kësaj garancie sovranë, ku shteti merr përsipër një risk të konsiderueshëm, përmes mbulimit deri në 70% të vlerës së kredisë, pritshmëria jonë është që bankat

të rrisin ndjeshëm nivelin e angazhimit dhe gatishmërinë për kreditimin e bujqësisë”, tha ministri Malaj.

“Ndaj kam bindjen se tashmë, me shtetin si garantues, nuk ka më vend për hezitim, pasi instrumentet janë në dispozicion”, vijoi ai.

Ministri Malaj u shpreh se zbatimi me efikasitet i Gran-cisë Sovrane kërkon pjesëmarrje aktive edhe nga vetë fermerët dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në të gjithë vendin.

Gjithashtu, Malaj tha se “të gjithë do të duhet të përfitojnë nga kjo mbështetje e drejtëpërdrejtë, për të investuar, për të zgjeruar aktivitetin bujqësor duke përfutur nga avantazhi që ofrojnë kreditë e buta me kushte të favorshme”.

“Është një mundësi që nuk duhet humbur, për të rritur prodhimin, për të modernizuar pajisjet, për të hyrë në agroturizëm, në përpunim, apo në sektorë të tjerë me potencial të madh”, cilësoi ai.

“Vetëm përmes një pjesëmarrjeje të gjerë dhe të organizuar të biznesit të vogël dhe të mesëm, të mbështetur nga një sistem bankar më aktiv dhe më proaktiv, do të mund të sigurojmë një shtrirje reale dhe efektive të kësaj nisme, duke garantuar që fondet të shkojnë aty ku ka më shumë nevojë dhe ku ndikimi është më i madh”, tha Malaj, ndërsa shtoi se Qeveria shqiptare, veçanërisht Ministria e Financave është e angazhuar të krijojë mjedisin e duhur financiar, ligjor dhe rregullator me qëllim nxitjen e investimeve në sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik.

“Garancia Sovrane për Bujqësinë është vetëm një nga hapat dhe suksesi i saj varet nga angazhimi i secilit prej nesh. Unë shpreh bindjen e plotë se duke punuar së bashku do të mund të ndërtojmë një model të ri zhvillimi i cili do të na shërbejë për ta bërë bujqësinë tonë më konkurruese, në kuadër edhe të procesit të integritetit evropian”, përfundoi Malaj.

Tatimet, fushatë informuese për formalizimin e tregut bujqësor dhe blegtoral

Administrata Tatimore ka nisur një fushatë informuese dhe ndërgjegjësuëse të drejtuar ndaj tatimpaguesve që merren me tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Kjo nismë synon të kontribuojë në formalizimin e tregut, të rrisë sigurinë ushqimore dhe të mbrojë konsumatorin.

Sipas njoftimit zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e

Tatimeve, për një periudhë dyjavore do të zhvillohet faza sensibilizuese, gjatë së cilës tatimpaguesit do të informohen mbi detyrimin ligjor për të shoqëruar çdo produkt me faturë tatimore të fiskalizuar.

Pas kësaj faze, një taskforcë e posaçme, e përbërë nga inspektorë të Hetimit Tatimor dhe të monitorimit në terren, do të fillojë kontrollet për të verifikuar respektimin e këtyre detyrimeve.

DPT paralajmëron se çdo rast i konstatimit të mungesës së faturës do të shoqërohet me masa ndëshkuese në përputhje me legjislacionin në fuqi.

“Fushata synon të forcojë zbatimin e ligjit dhe të vendosë barazi fiskale ndërmjet tatimpaguesve, duke rritur gjithashtu transparencën dhe besimin në zinxhirin e furnizimit ushqimor”, bën të ditur DPT.

ITC PROJECT - ALBANIA

Rezultate dhe konkluzione mbi “Parametrat analitikë të vlerësimit të cilësisë dhe pastërtisë së vajit të ullirit për eksport”

Prof. Assoc. Dr. Anila Kopali
Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, Universiteti Bujqësor i Tiranës

https://www.fao.org/fao-who-codexalimentarius/codex-texts/dbs/pestres/commodities-detail/en/?c_id=152

Prodhimi i vajit të ullirit në Shqipëri Sezoni 2024-2025

- Sipas COI : 30,000 ton
- Konsumi brenda vendit: 18,000 ton/vit
- Sasi për eksport: 12,000 ton
- Eksporte:
 - Gjatë 2024 - u eksportuan 4560 ton vaj ulliri.
 - Janar - Mars 2025: 322 ton - 75% me pak si sasi dhe 81% me pak në vlerë - krahasuar me të njëjten periudhë të vitit të kaluar.

Çmime shitje me shumicë - jokooperative, krahasuar me vende si: Spanja, Greqia, Tunizia, Italia.

Eksporti i Vajit të Ullirit-përse është i vështirë?

Një shqetësim i vetëm përfshin pjesën më të madhe të problemeve:

CILESIA E ULET

Faktoret që ndikojnë në uljen e cilësisë

- Fragmentizim i theksuar i tokës/mungesë kooperimi e bashkepunimi
- Shkallë e ulët mekanizimi/kosto e lartë e prodhimit
- Kapacitete të ulëta dhe shpesh jo të pershtatshme depozitim/ruajtje e vajit të prodhuar
- Shërbime të dobëta agronomike dhe fitosanitare të ullinjve
- Mungesë certifikimi DOP/IGP
- Sasi e ulët eksportesh me vaj të ambalazhuar, me brand të caktuar dhe cilësi të lartë.
- Zbatimi jo korrekt i praktikave të mira të punës në përpunim (ulli i ndenjur dhe i demtuar, temp. të larta ekstraktimi, larje jo adekuate, mungesë filtrimi dhe prezencë lageshtie në vaj etj).

Përmirësimi i cilësisë

shoqëruar me

Depozitim i përqendruar -Ambalazhimi -
Brandim - Certifikim

janë

mënyrat më të rëndësishme për rritjen
e eksporteve dhe përfitimeve nga ky
produkt

Analizat që u kryen nga projekti

Parametrat e cilësisë dhe pastërtisë së vajrave

PARAMETRI	METODA E MATJES
Aciditeti (% acid oleik)	COI/T.20/Doc.No.34/Rev.1 2017
Peroksidet (mekO ₂ /kg)	COI/T.20/Doc.No.35/Rev.1 2017
Indexet e përthithjes: K232, K270 dhe ΔK	COI/T.20/Doc.No.19/Rev.5 2019
Polifenole totale (mg/kg)	Folin Ciocalteu/UV Spectrophotometry
Alkyl Estere (Metil estere; etil estere; total) (mg/kg)	COI/T.20/Doc.No.28/Rev.3 2022

Parametra të sigurisë

Mbetje të shumëfishta
(Insekticide, Fungicide, Herbicide) - 350 lloje

UNIEN 15662: 2018

Laboratorët e përdorur

- Chemiservice s.r.l - Monopoli, Bari - i akredituar

- Analiza e mbetjeve pesticide
- Përmbajtja e Alkil Estereve

- Biovet Laboratory - Tiranë - i certifikuar

- Aciditet
- Tregues përthyerje K232, K270 dhe ΔK
- Numër Peroksidesh

- Laboratori i Qendrës Kërkimore të Ushqimit - UBT

- Polifenole totale

Rezultatet e analizave të cilësisë

Kampion Nr.	Aciditet (% ac.oleik)	Peroxide (meqO ₂ /kg)	Alkylestere (mg/kg)			Indexet e përthithjes		
			Methyl estere	Ethyl estere	Total	K232	K270	ΔK
1	0.93	11.24	33	69	102	1.37	0.15	0.00
2	0.28	13.97	2	1	3	1.71	0.13	0.00
3	0.33	9.12	2	4	6	1.57	0.16	0.00
4	0.36	12.5	4	1	5	2.28	0.17	0.00
5	0.25	15.97	3	3	6	2.08	0.15	0.00
6	0.28	12.82	2	1	3	1.82	0.14	0.00
7	0.25	9.86	2	1	3	2.01	0.14	0.00
8	0.45	23.01	10	16	26	2.19	0.23	0.00
9	0.30	11.9	1	2	3	1.7	0.12	0.00
10	0.26	12.02	1	1	2	2.22	0.19	0.00

Rezultatet e analizave të mbetjeve

Nr. Kampion	Prani Mbetje	Lloji i mbetjes	Niveli i detektuar (mg/kg)	MRL mg/kg	Polifenole mg/kg
1	PO	FENVALERATE (isomeri SS, RR, RS, e SR, Esfenvalerate)	0.66	I ndaluar	196
2	PO	LAMBDA CYHALOTHRIN (includes gamma cyhalothrin) (Insecticides)	0.005 (Gjurmë)	I ndaluar për vaj	238
3	PO	CHLORPYRIFOS ETHYL (Insecticides)	0.008 (Gjurmë)	I ndaluar	390
		CYPERMETHRIN included alpha, beta, theta, zeta Cypermethrin (Insecticides)	0.008 (Gjurmë)	0.5	
4	JO	-	-	-	188
5	PO	CHLORPYRIFOS ETHYL (Insecticides)	0.074	I ndaluar	250
		CYPERMETHRIN included alpha, beta, theta, zeta Cypermethrin (Insecticides)	0.053	0.5	
		DIFENOCONAZOLE (Fungicides)	0.005 (Gjurmë)	I ndaluar për vaj	
		LAMBDA CYHALOTHRIN (includes gamma_x0002_cyhalothrin) (Insecticides)	0.005 (Gjurmë)	I ndaluar për vaj	
6	JO	-	-	-	157
7	JO	-	-	-	260
8	JO	-	-	-	325
9	PO	CHLORPYRIFOS ETHYL (Insecticides)	0.036	I ndaluar	190
		CYPERMETHRIN included alpha, beta, theta, zeta Cypermethrin (Insecticides)	0.015	0.5	
10	JO	-	-	-	300

Pesticidet e lejuara në vaj ulliri dhe nivelet e lejuara të tyre

Pesticide	MRL	Viti i aprovimit
Buprofezin	20 mg/Kg	2021
Carbaryl	25 mg/Kg	2004
Cypermethrins (including alpha- and zeta-cypermethrin)	0.5 mg/Kg	2009
Fenthion	1 mg/Kg	
Kresoxim-Methyl	1 mg/Kg	2019
Pyraclostrobin	0.07 mg/Kg	2019
Trifloxystrobin	0.9 mg/Kg	2013

Pesticidet e lejuara në ullinj tavoline dhe nivelet e lejuara të tyre

Pesticide	MRL	Year of Adoption	Symbol
Buprofezin	5 mg/Kg	2010	
Carbaryl	30 mg/Kg	2004	
Cyhalothrin (includes lambda-cyhalothrin)	1 mg/Kg	2009	
Cypermethrins (including alpha- and zeta-cypermethrin)	0.05 mg/Kg	2009	(*)
Deltamethrin	1 mg/Kg	2004	
Difenoconazole	2 mg/Kg	2008	
Ethephon	7 mg/Kg	2016	
Fenthion	1 mg/Kg	1997	
Fluazifop-p-butyl	0.01 mg/Kg	2017	(*)
Flumioxazin	0.02 mg/Kg	2016	(*)
Imidacloprid	2 mg/Kg	2016	
Kresoxim-Methyl	0.2 mg/Kg	2019	
Paraquat	0.1 mg/Kg	2006	
Permethrin	1 mg/Kg		
Pyraclostrobin	0.01 mg/Kg	2019	
Spinetoram	0.07 mg/Kg	2018	
Tebuconazole	0.05 mg/Kg	2012	(*)
Trifloxystrobin	0.3 mg/Kg	2013	

INFORMACIONE

AmCham, LeaderImpact dhe LinkAcross forum mbi rritjen e bizneseve me fokus te qëndrueshmëria dhe integriteti

Forumi “Të udhëheqësh nga qëllimi: Financa të zgjuara, rritje të qëndrueshme dhe vizion global” i organizuar nga Dhoma Amerikane e Tregtisë në bashkëpunim me Leader Impact dhe LinkAcross u kthye

Miles” dhe Scott Miller, strateg financiar kryesor pranë “One Atlanta – Tax Solutions,” qëndroi ideja se çdo biznes është unik dhe kërkon një qasje të personalizuar për të ruajtur veçantitë e veta. Të

kujdesshëm operacional, duke ofruar këshilla të vlefshme për pjesëmarrësit që synojnë rritje të qëndrueshme dhe me integritet.

Më pas, Scott Miller ndau me pjesëmarrësit elementët



në një hapësirë reflektimi mbi vlerat mbi të cilat udhëhiqet një biznes sot.

Takimi u përshëndet nga dy drejtuesit Neritan Mullaj, drejtor ekzekutiv i AmCham Albania dhe Daniel Elliot, drejtor i LeaderImpact të cilët theksuan rëndësinë e forumit për të nxjerrë njohuri praktike se si bizneset mund të zgjerojnë operacionet ndërkombëtare, të zbatojnë praktika të forta financiare dhe të rriten qëndrueshëm duke qëndruar besnik ndaj vlerave të tyre thelbësore.

Në qendër të diskutimeve të Hiro Isogawa, themelues dhe CEO i firmës kontabël “Two

dy lektorët u përqendruan në fjalët e tyre në faktin se pavarësisht sfidave në tregjet ndërkombëtare, nuk duhet bërë kompromis me cilësinë apo me thelbin e identitetit të kompanisë. Ky qëndrim u ilustrua me përvoja konkrete të sipërmarrësve që kanë ndërtuar operacione ndërkombëtare duke ruajtur identitetin e brendshëm të kompanisë.

Hiro Isogawa, themelues dhe CEO i firmës kontabël “Two Miles”, ndau përvoja personale nga ndërtimi i një biznesi ndërkombëtar. Ai theksoi rëndësinë e udhëheqjes me vlera dhe të shkallëzimit të

kryesorë strategjikë që çdo sipërmarrës duhet të zotërojë nga delegimi i përgjegjësisë dhe fuqizimit të punonjësve. Rritja dhe zhvillimi i kompanive nuk mund të ndodhë pa rritjen e vetë njerëzve që i përbëjnë ato.

Miller theksoi se një lider i mirë nuk e mban kontrollin për vete, por krijon hapësira që të tjerët të rriten bashkë me kompaninë. Biznesi nuk shihet thjesht si një strukturë ekonomike, por si një komunitet me ndikim real në jetët e njerëzve, ku suksesi matet jo vetëm me bilanci financiar, por edhe me trashëgiminë etike që lë pas.

Fermeri nga Tërbufi rrit prodhimin për eksport me mbështetje nga Skema Kombëtare

Resmi Yzeiri, fermer nga Tërbufi, prej vitesh është i përkushtuar ndaj bujqësisë duke kultivuar specia për ek-

sport në një sipërfaqe prej 2,7 hektarësh.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit, Anila Denaj e cila

ndau historinë e tij, tha se me punë të palodhur dhe standarde të larta prodhimi, ai ka arritur të jetë pjesë e rrjetit të fermerëve që kontribuojnë në fuqizimin e markës “Made in Albania” në tregjet ndërkombëtare, ndërsa jep një shembull të suksesshëm të zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë në zonat rurale.

Në rrugëtimin e tij si bujk i specializuar për tregjet e huaja, Yzeiri është një nga përfituesit e Skemës Kombëtare të Mbështetjes në bujqësi.

Kjo skemë ka qenë një shtysë e rëndësishme për rritjen e rendimentit dhe cilësisë së prodhimit, duke i mundësuar të modernizojë proceset bujqësore dhe të përmbushë kërkesat e tregjeve të jashtme.

“Përmes Skemës Kombëtare të Investimeve, me 50% grant dhe mbështetjes nga Kredia e Butë të kombinuar me Garancinë Sovrane, çdo fermer mund të përfitojë financim me normë interesi vetëm 2% dhe mbulim kolateral deri në 70%”, bëri të ditur ministrja Denaj.



Dëmshpërblim për murtajën, me qindra bagëti janë infektuar dhe po ngordhin/ Ekspertët: Dëmtohen blegtorët

Fermerët e prekur nga murtaja e ruminantëve nuk janë dëmshpërblyer, kjo sepse sëmundja e murtajës nuk është pjesë e kalendarit të infeksioneve të dëmshpërblimit

Blegtoria shqiptare preket për herë të parë nga murtaja që shfaros bagëtinë e imët. Eksperti i Ekonomisë, Klodian Muço, thotë se nëse Ministria

ës, sepse të njëjtën gjë e pamë në Greqi. Duhet menjëherë mbështetje, subvencionim ndaj fermerëve shqiptarë që kjo zgjidh pjesërisht problemin”,

bulmetit.

Eksperti i ekonomisë, Majlind Lazimi thotë: “Kërkesa dhe oferta do të diktojnë çmimet, mungesa e produkteve shqiptare do të duhet të kompensohet me produktet e importit të cilat, gjithashtu për shkak të regjimit taksor, do të vijnë me çmim më të lartë. Kështu që nevoja për të pasur produkte shqiptarë cilësorë dhe sasiore duhet të jetë prioritet i qeverisë.”

Një kilogram djathë, gjalpë dhe dele shqiptarë do të kushtojë më tepër nëse Ministria e Bujqësisë nuk zëvendëson në kohë krrerët e prekur nga murtaja.

“Çmimet, koha ka treguar, që në Shqipëri nuk ka një limit, tendenca është që të kemi një rritje dyshifrore në vit, duke dëmtuar konsumatorët shqiptarë dhe turizmin”, shton Klodian Muço.

Murtaja e ruminantëve deri më tani është e përhapur në katër vatra: Shkodër, Dibër, Bulqizë dhe Korçë. Masat parandaluese nuk po e stopojnë dot përhapjen e murtajës.



e Bujqësisë nuk dëmshpërblen në kohë fermerët, pasojat në ekonominë blegtoriale do të jenë më negative.

“Ne gjithmonë e më tepër po varemi nga importet për sa i përket blegtorisë, pra produkteve të mishit dhe të qumështit. Në të tilla kushte ku ndodhet fermeri shqiptar, që do të thojë që është në përmasat e tragjik-

thotë Muço.

Murtja e ruminantëve është tepër e rrezikshme, pasi ky infeksion shkakton mortalitet të lartë të delet dhe dhitë. Kjo do të thotë që në Shqipëri do të mungojë mishi dhe qumështi i tyre. Nga ana tjetër, sezoni turistik rrit kërkesat për produktet vendase, kjo kërkesë do të ndikojë në rritjen e çmimit të

Temperaturat e larta nuk ndalin fermerët e Kukësit, pas korrijës së grurit ka nisur mbjellja e misrit

Pavarësisht temperaturave të larta të kësaj periudhe, fermerët në Kukës vijojnë pa ndërprerje punën në arat e tyre.

Brahim Hoxha, 74 vjeç, së bashku me bashkëshorten po merren me ujitjen e misrit të sapombjellë pas korrijës së tërshërës.

I kalitur me punë gjithë jetën e tij, ai thotë se nuk e ka problem të nxehtin.

Misri, sipas tij, përfundon në shtator dhe ujitja organizohet me ditë të caktuara për të siguruar rendimentin maksimal.

“Nga 15 tetori deri në 1 nëntor kjo i mbaron punët e veta,” thotë zonja e tij.



Ndërkohë, kanalet ujitëse vijojnë të furnizojnë me ujë parcelat e fshatrave të Kukësit,

ku janë mbjellë kulturat bujqësore sezonale në fund të muajit qershor.

Dokumenti i Kadastrës/ Si do bëhet regjistrimi i tokave me 7501?!

Bashkë me regjistrimin fillestar, Agjencia e Kadastrës synon që deri në 2028-n të përfundojë skanimin dhe digjitalizimin të kartelave të pasurisë dhe hartave kadastrale.

Krahas fondeve buxhetore dhe mbështetjes nga Bashkimi Evropian, për përmbylljen e këtij procesi do të shihet mundësia e dhënies së disa shërbimeve me koncension.

“Do të eksplorohej mundësitë për përfshirjen e sektorit privat përmes mekanizmeve të partneritetit publiko-privat, aty ku kjo është e përshtatshme dhe sjell vlerë të shtuar” thuhet në dokumentin “Udhërrëfyes i digjitalizimit të Agjencisë Shtetërore të

Kadastrës 2025-2028”.

